

VENDIM
Nr.244, datë 23.4.2004

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT DHE TË SKEMËS SË FURNIZIMIT ME
KARBURANT PA AKCIZË, PËR PËRCAKTIMIN E SASIVË TË KARBURANTIT, QË DO
TË PËRDOREN PËR MEKANIKËN BUJQËSORE NË TRI ZONA TË VENDIT DHE PËR
SERAT ME NGROHJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 19 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fermerët që kryejnë punime bujqësore të mekanizuara në bujqësi, të përfshirë në zonat: Sarandë-Delvinë, Fier-Divjakë dhe Fushë-Krujë-Lezhë të furnizohen me karburant e lubrifikant pa akcizë.

2. Armo sh.a. t’i furnizojë këto zona me 8 400 ton gazoil dhe 252 ton vajra lubrifikant pa akcizë, për plotësimin e nevojave të fermerëve, që përfitojnë nga ky vendim, për periudhën maj 2004-korrik 2005.

3. Të gjitha subjektet private në të gjithë vendin, që kultivojnë kultura bujqësore në sera me ngrohje, të furnizohen me 3 000 ton naftë dhe 2 000 tonë solar pa akcizë.

4. Fondet kundërparti në shumën 195 000 000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekë, të realizuara nga shitja e mallrave të ardhura në kuadër të projektit grant të Qeverisë japoneze, si mbështetje buxhetore, të përdoren për mbështetjen e këtij projekti pilot, si më poshtë vijon:

- 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë, të cilat të kalojnë nga llogaritë respektive të Bankës së Shqipërisë në llogaritë respektive të projektit “2KR”, për kreditimin me afat të shkurtër kohor të përfituesve nga ky vendim, për blerjen e karburantit, të lubrifikantit dhe lëndës djegëse nga ARMO, sh.a.

- 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, të cilat të kalojnë nga llogaritë respektive të Bankës së Shqipërisë në llogaritë respektive të projektit “2KR” për kreditimin me afat të mesëm kohor pa interes të subjekteve private të agromenakizatorëve, që veprojnë në zonat e përfshira në projektin pilot, për furnizimin e këtyre subjekteve me pajisje matëse, transporti dhe ruajtjeje të karburantit.

5. Procedurat e përdorimit të këtyre fondeve të bëhen sipas marrëveshjeve të nënshkruara me Qeverinë japoneze, sipas përcaktimeve të vendimeve nr.148, datë 31.3.2000 “Për mënyrën e shitjes së mallrave të ardhura grant nga Japonia, në kuadër të projektit “Shtimi i prodhimeve ushqimore”, 2KR” e nr.485, datë 21.10.1999 “Për miratimin e shpërndarjes së fondeve të dhëna nga Qeveria e Japonisë, si mbështetje buxhetore për përbalimin e situatës së krijuar për shkak të krizës në Kosovë” të Këshillit të Ministrave, si dhe udhëzimeve të përbashkëta të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe Ministrit të Financave.

6. Procedurat e zbatimit të këtij projekti pilot dhe skemat e shpërndarjes së karburantit caktohen me një udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

7. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano